

Në bazë të nenit 62, paragrafi 1 pika 15) të Ligjit për këshillat kombëtarë të pakicave kombëtare ("Fletorja zyrtare e RS" nr. 72/09, 20/14 - US, 55/14 dhe 47/18),

Komisioni Zgjedhor i Republikës, në seancën e mbajtur më 5 shtator 2022 miratoi

U D H Ë Z I M I N

PËR ZBATIMIN E ZGJEDHJEVE TË DREJTPËRDREJTA PËR ANËTARËT E KËSHILLAVE TË PAKICAVE KOMBËTARE*

I DISPOZITA HYRËSE

Neni 1

Ky udhëzim rregullon procedurën e zbatimit të zgjedhjeve të drejtpërdrejta për anëtarët e këshillave kombëtarë të pakicave kombëtare (në tekstin e mëtejshëm: zgjedhjet).

II ORGANET DHE AUTORITETET PËR ZBATIMIN E ZGJEDHJEVE

Neni 2

Organet për zbatimin e zgjedhjeve janë Komisioni Zgjedhor i Republikës dhe këshillat e vendvotimit.

Komisioni Zgjedhor i Republikës

Neni 3

(1) Komisioni Zgjedhor i Republikës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) kryen punët e përcaktuara në Ligjin për këshillat kombëtarë të pakicave kombëtare dhe në këtë udhëzim.

(2) Komisioni mund të autorizojë një anëtar ose zëvendës anëtar (në tekstin e mëtejshëm: koordinator) që të kryejë, në emër të Komisionit, disa veprime të lidhura me organizimin, përgatitjen dhe zbatimin e zgjedhjeve ose votimit në rrethin administrativ dhe qytetin e Beogradit.

Organet e punës së Komisionit

Neni 4

(1) Për ofrimin e ndihmës teknike në organizimin e zgjedhjeve, Komisioni formon organet e punës së Komisionit (në tekstin e mëtejshëm: organet e punës).

(2) Organi i punës formohet për territorin e njëjës ose më shumë njësisive të vetëqeverisjes lokale, si dhe për territorin e njëjës ose disa komunave të qytetit të Beogradit.

(3) Organet e punës nuk janë organet për zbatimin e zgjedhjeve, por vetëm kryejnë punët e parashikuara në këtë udhëzim.

* „Gazeta zyrtare RS“, numer 100/22.

(4) Organet e punës:

- 1) kujdesen për rregullimin e vendvotimeve;
- 2) pranojnë materialin zgjedhor nga koordinatori dhe ua dorëzojnë atë këshillave të vendvotimit para votimit;
- 3) marrin materialin zgjedhor nga këshillat e vendvotimit pas votimit dhe ua dorëzojnë koordinatorëve;
- 4) u ofrojnë mbështetje këshillave të vendvotimit gjatë zbatimit të votimit;
- 5) kryejnë edhe punët e tjera në përputhje me këtë udhëzim dhe aktet e veçanta të Komisionit.

Përbërja e organit të punës

Neni 5

(1) Organi i punës përbëhet nga anëtarët e emëruar me propozim të kryetarit të administratës së komunës/qytetit ose të kryetarit të organit të administratës së komunës/qytetit, i cili është kompetent për çështjet zgjedhore dhe kryetarit të organit të administratës së komunës së qytetit të Beogradit (në tekstin e mëtejshëm: kryetari i administratës) nga radhët e personave me arsim të lartë të punonjësve në sektorin publik (organet shtetërore, organet e autonomisë territoriale dhe vetëqeverisjes lokale, institucionet dhe kompanitë publike). Gjatë propozimit të kandidatëve për anëtarët e organeve të punës, përparësia duhet t'u jepet personave të regjistruar në listat e veçanta zgjedhore të pakicave kombëtare që kanë arsim të lartë në fushën e shkencave juridike dhe përvojë në zbatimin e zgjedhjeve.

(2) Nëse organi i punës formohet për territorin e një njësie të vetëqeverisjes lokale që ka deri në dhjetë vendvotime, organi i punës ka tre anëtarë.

(3) Nëse organi i punës formohet për territorin e një njësie të vetëqeverisjes lokale që ka deri nga dhjetë deri në njëzet vendvotime, organi i punës ka pesë anëtarë.

(4) Nëse organi i punës formohet për territorin e një njësie të vetëqeverisjes lokale që ka mbi njëzet vendvotime, organi i punës ka shtatë anëtarë.

(5) Nëse organi i punës formohet për territorin e disa njësive të vetëqeverisjes lokale, ose disa komuna të qytetit të Beogradit, organi i punës ka aq anëtarë sa ka njësi të vetëqeverisjes lokale, ose komuna të qytetit, që emërohen me propozim të kryetarëve të administratave të secilës prej njësive të përfshira të vetëqeverisjes lokale ose të komunave të qytetit. .

(6) Në përbërjen e organit të punës hyn edhe kryetari i administratës.

(7) Nëse organi i punës formohet për territorin e disa njësive të vetëqeverisjes lokale, ose disa komunave të qytetit të Beogradit, në përbërjen e organit të punës hyn edhe kryetarët e administratave të këtyre njësive të vetëqeverisjes lokale, ose të komunave të qytetit.

(8) Nëse kryetari i administratës nuk ka mundësi të ushtrojë detyrën e anëtarit të organit të punës, në organin e punës hyn zëvendësi i tij. Nëse as zëvendësi i kryetarit të administratës nuk ka mundësi të ushtrojë detyrat e anëtarit të organit të punës, kryetari i administratës do të propozojë për përbërjen

e organit të punës një person të punësuar në administratën e komunës/qytetit i cili përmbush kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni.

(9) Kryetari i administratës siguron kushtet për punën e organit të punës dhe koordinon punën e tij.

(10) Puna e organit të punës të formuar për territorin e disa njësve të vetëqeverisjes lokale, ose të disa komunave të qytetit të Beogradit, koordinohet nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes lokale, ose të komunës së qytetit me numrin më të madh të votuesve të regjistruar në listat e veçanta të votuesve të pakicave kombëtare..

Neni 6

Komisioni me akt të veçantë përcakton numrin, përbërjen dhe fushëveprimin e punës së organeve të punës, jo më vonë se 30 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve.

Neni 7

(1) Propozimet për emërimin e anëtarëve të organit të punës paraqiten në Komision nga kryetarët e administratave jo më vonë se pesë ditë nga dita e miratimit të vendimit nga neni 6 i këtij udhëzimi.

(2) Propozimi për emërtim duhet të përmbajë: Emrin dhe mbiemrin, numrin unik identifikues të qytetarit (në tekstin e mëtejshëm: JMBG), profesionin, vendin dhe adresën e banimit, numrin e celularit për kontakt dhe adresën e postës elektronike.

(3) Koordinatori është i autorizuar për të propozuar ndryshimin e propozimit të kryetarit të administratës për emërimin e anëtarit të organit të punës, dhe është i detyruar ta arsyetojë atë.

(4) Nëse kryetari i administratën nuk propozon një anëtar të organit të punës brenda kohës së parashikuar, Komisioni do të emërojë një person të përshtatshëm për anëtar të organit të punës.

(5) Komisioni formon organet e punës jo më vonë se 20 ditë para ditës së zgjedhjeve.

Përbërja e këshillit të vendvotimit

Neni 8

(1) Këshilli i vendvotimit përbëhet nga kryetari, katër anëtarë dhe zëvendësit e tyre të emëruar me propozim të kryetarit të administratës.

(2) Për kryetarin e këshillit të vendvotimit dhe zëvendës kryetarin e këshillit të vendvotimit emërohen personat e punësuar në sektorin publik (organet shtetërore, organet e autonomisë territoriale dhe të vetëqeverisjes lokale, institucionet, kompanitë publike).

(3) Gjatë propozimit të kryetarit, zëvendës kryetarit, anëtarëve dhe zëvendës anëtarëve të këshillave të vendvotimit, përparësia duhet t'u jepet personave të regjistruar në listat e veçanta të votuesve të pakicave kombëtare.

(4) Gjatë propozimit të kryetarit të këshillit të vendvotimit, përparësia duhet t'i jepet personit me arsim të lartë dhe me pervojë në zbatimin e zgjedhjeve.

(5) Gjatë propozimit të anëtarëve për këshillat e vendvotimit, kryetarët e administratave duhet të kujdesen për përfaqësimin e balancuar të

gjinive dhe nevojën për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në zbatimin e procedurës zgjedhore.

Neni 9

(1) Kryetarët, zëvendës kryetarët, anëtarët dhe zëvendësanëtarët e këshillit të vendvotimit emërohen nga Komisioni.

(2) Vendimi për formimin e këshillave të vendvotimit dhe emërimin e kryetarëve dhe anëtarëve të këshillave të vendvotimit dhe zëvendësve të tyre merret nga Komisioni, jo më vonë se dhjetë ditë para mbajtjes së zgjedhjeve.

Neni 10

(1) Propozimi për emërimin e personave në listat zgjedhore dorëzohet në Komision nga kryetari i administratës, jo më vonë se 15 ditë para ditës së zgjedhjeve.

(2) Në propozimin për emërtim jepen të dhënat në vijim për personat e propozuar: emër dhe mbiemër, JMBG, vendi dhe adresa e banimit, numri i celularit dhe adresa e postës elektronike.

(3) Koordinatori është i autorizuar për të propozuar ndryshimin e propozimit të kryetarit të administratës për emërimin e personave në këshillat e vendvotimit, dhe është i detyruar ta arsyetojë atë.

(4) Nëse kryetari i administratës nuk propozon një person për këshillin e vendvotimit brenda kohës së parashikuar, Komisioni do të emërojë një person të përshtatshëm për kryerjen e kësaj detyre në këshillin e vendvotimit.

Kufizimet ligjore

Neni 11

(1) Një person mund të emërohet vetëm në një organ për zbatimin e zgjedhjeve.

(2) Në këshillin e vendvotimit nuk mund të propozohet dhe të emërohet një person që është anëtar i këshillit kombëtar ose kandidat për anëtar në këshillin kombëtar.

(3) Gjatë propozimit të emërimit të anëtarit dhe zëvendës anëtarit në këshillin e vendvotimit, kryetari i administratës është i detyruar të kujdeset për kufizimet ligjore nga pikëpamja e anëtarësisë në këshillin e vendvotimit.

Ndryshimi i personave në këshillin e vendvotimit

Neni 12

(1) Ndryshimi i personit të emëruar në këshillin e vendvotimit me propozim të kryetarit kompetent të administratës bëhet jo më vonë se tri ditë para ditës së zgjedhjeve.

(2) Përrjashtimisht, kryetari dhe zëvendëskryetari i këshillit të vendvotimit mund të zëvendësohen jo më vonë se para hapjes së vendvotimit në qoftë se vdesin, sëmuren ose humbasin të drejtën elektorale.

(3) Para dorëzimit të materialit zgjedhor në organet e punës, ndryshimi i personave në këshillin e vendvotimi kryhet nga Komisioni, ndërsa pas dorëzimit kryhet nga koordinatori.

III PARAQITJA E LISTËS ZGJEDHORE

Kush mund të paraqesë listën zgjedhore

Neni 13

Lista zgjedhore e kandidatëve për anëtarët e këshillit kombëtar (në tekstin e mëtejshëm: lista zgjedhore) mund të paraqitet nga: Grupi i votuesve të regjistruar në listën e veçantë të votuesve të pakicës kombëtare, shoqata qëllimi i së cilës realizohet në fushën e mbrojtjes së të drejtave të pakicës kombëtare këshilli kombëtar i së cilës është duke u zgjedhur dhe partia e regjistruar politike e pakicës kombëtare këshilli kombëtar i së cilës është duke u zgjedhur (në tekstin e mëtejshëm: propozuesi i listës zgjedhore).

Grupi i votuesve si propozuesi i listës zgjedhore

Neni 14

(1) Grupi i votuesve formohet nga të paktën tre votues të regjistruar në listën e veçantë të votuesve të pakicës kombëtare këshilli kombëtar i së cilës është duke u zgjedhur.

(2) Grupi i votuesve formohet me marrëveshje të shkruar e të vulosur pranë organit kompetent për vulosjen e nënshkrimeve në përputhje me ligjin që rregullon vulosjen e nënshkrimeve.

(3) Marrëveshja për formimin e grupit të qytetarëve duhet të përmbajë:

1) qëllimet e formimit të grupit të votuesve ose deklaratën që grupi i votuesve organizohet me qëllim të pjesëmarrjes në zgjedhjet e drejtpërdrejta të shpallura për anëtarët e këshillit kombëtar të pakicës kombëtare;

2) të dhënat për themeluesit (emër dhe mbiemër, JMBG, vendi dhe adresa e banimit, sipas të dhënave nga letërnjoftimi);

3) personin nga radhët e grupit të votuesve që është caktuar si përfaqësuesi i grupit të votuesve;

4) emrin e grupit të votuesve i cili duhet të përmbajë shenjë „Grupi i votuesve“;

5) emrin e listës zgjedhore e cila po paraqitet (që përfshin edhe mbartësin e listës zgjedhore, nëse është i caktuar);

6) datën e lidhjes së marrëveshjes.

(4) Marrëveshja për formimin e grupit të votuesve duhet të lidhet dhe të vuloset pas hyrjes në fuqi të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve, dhe para fillimit të mbledhjes së nënshkrimeve të votuesve për mbështetjen e tyre në listën zgjedhore.

(5) Marrëveshja për formimin e grupit të votuesve përpilohet në gjuhën serbe me alfabet cirilik, por mund të përpilohet edhe në gjuhën dhe alfabetin e pakicës kombëtare, në mënyrë që çdo nen të marrëveshjes të përmbajë së pari tekstin në gjuhën serbe dhe alfabetin cirilik, dhe më tej ky tekst të jepet në gjuhën dhe alfabetin e pakicës kombëtare.

(6) Lista zgjedhore në emër të grupit të votuesve paraqitet nga personi i caktuar për të përfaqësuar grupin e votuesve, ose personi i autorizuar nga ai, në një formular të parashikuar nga Komisioni.

Shoqatë si propozuesi i listës zgjedhore

Neni 15

Lista zgjedhore në emër të shoqatës paraqitet nga përfaqësuesi i shoqatës i regjistruar në Regjistrin e shoqatës, ose personi i autorizuar nga ai, në një formular të parashikuar nga Komisioni.

Partia politike e pakicës kombëtare si propozuesi i listës zgjedhore

Neni 16

Lista zgjedhore paraqitet në emër të partisë politike të pakicës kombëtare nga përfaqësuesi i partisë politike që është regjistruar në Regjistrin e partive politike ose personi i autorizuar nga ai, në një formular të parashikuar nga Komisioni.

Pozita e personit të autorizuar për paraqitjen e listës zgjedhore

Neni 17

Personi i autorizuar për paraqitjen e listës zgjedhore, është i autorizuar për të kryer të gjitha veprimet e tjera zgjedhore në emër të propozuesit të listës zgjedhore, përveç nëse paraqitësi i listës zgjedhore nuk përcakton ndryshe duke e njoftuar me shkrim Komisionin.

Afati për paraqitjen e listës zgjedhore

Neni 18

Lista zgjedhore paraqitet jo më vonë se 15 ditë para ditës së zgjedhjeve.

Mënyra dhe koha e paraqitjes së listës zgjedhore

Neni 19

(1) Lista zgjedhore paraqitet drejtpërdrejtë në Komision në ndërtesën e Ansamblesë Popullore në Beograd, rruga Kralja Milana 14.

(2) Lista zgjedhore mund të paraqitet çdo ditë pune, në kohën nga ora 9,00 deri në 17,00, përveç ditës së fundit për paraqitjen e listës zgjedhore kur lista mund të paraqitet deri në orën 24,00. Paraqitja e listës zgjedhore duhet të paralajmërohet një ditë më parë deri në orën 17,00, me postë elektronike te adresa rik@parlament.rs.

(3) Përjashtimisht, lista zgjedhore mund të paraqitet edhe në ditët e fundjavës, ku paraqitja paralajmërohet të premtën deri në orën 17,00, kurse koha e paraqitjes caktohet nga kryetari i Komisionit. Gjatë caktimit të kohës së paraqitjes së listës zgjedhore duhet të respektohet renditja e regjistrimit të paraqitjes së listave zgjedhore.

Përmbajtja e listës zgjedhore

Neni 20

(1) Lista zgjedhore paraqitet në formularin e parashikuar nga Komisioni, në formë të shkruar ose elektronike (CD, DVD ose USB).

(2) Përmbajtja e listës zgjedhore në formë të shkruar dhe në formë elektronike duhet të jetë identike.

(3) Lista zgjedhore përmban:

- 1) emrin e propozuesit të listës zgjedhore;
- 2) emrin e listës zgjedhore, që mund të përmbajë edhe emrin dhe mbiemrin e një personi (mbartësi i listës zgjedhore);
- 3) të dhënat për të gjithë kandidatët për anëtarët e këshillit kombëtar (numri rendor në listën zgjedhore, emrin dhe mbiemrin, JMBG, profesionin, vendin dhe adresën e banimit të kandidatit);
- 4) emrin, mbiemrin, JMBG, vendin dhe adresën e vendbanimit, numrin e telefonit dhe adresën për marrjen e postës elektronike dhe nënshkrimin e personit që paraqet listën zgjedhore.

(4) Në listën zgjedhore duhet të jetë të paktën një e treta e kandidatëve që vijnë nga radhët e anëtarëve të këshillit kombëtar që është duke u zgjedhur, dhe jo më shumë se aq kandidatë sa ka anëtarë të këshillit kombëtar që është duke u zgjedhur.

(5) Kandidat mund të jetë vetëm personi i regjistruar në listën e veçantë të votuesve të pakicës kombëtare këshilli kombëtar i së cilës është duke u zgjedhur.

(6) Emrat dhe mbiemrat e kandidatëve jepen në listën zgjedhore sipas drejtshkrimit të serbishtes dhe me alfabet cirilik, dhe mund të jepen edhe sipas drejtshkrimit dhe alfabetit të pakicës kombëtare, ku renditja përcaktohet nga propozuesi i listës zgjedhore.

(7) Në listën zgjedhore, në çdo tre kandidatë sipas renditjes në listë (tre vendet e para, tre vendet e tjera dhe kështu deri në fund të listës) duhet të jetë jo më pak se një kandidat nga gjinia e përfaqësuar më pak në listën zgjedhore.

(8) Nëse lista zgjedhore nuk përmbush kushtet përmbajtësore nga ky nen, do të konsiderohet se ka mangësi në shpallje.

Emri i propozuesit të listës zgjedhore

Neni 21

(1) Nëse lista zgjedhore paraqitet nga grupi i votuesve, ai është i detyruar të vendosë si emër të propozuesit në listën zgjedhore dhe në të gjitha dokumentet e tjera zgjedhore emrin e vetë nga marrëveshja për formimin e grupit të votuesve. Emri i grupit të votuesve duhet të përmbajë në fillim shenimin "Grupi i votuesve" dhe nuk mund të përmbajë fjalën "parti" ose "shoqatë" në asnjë rasë, dhe as emrin e një partie të regjistruar politike ose të shoqatës së regjistruar.

(2) Nëse lista zgjedhore paraqitet nga shoqata, ajo është e detyruar të vendosë emrin e saj si propozues të listës zgjedhore sipas emrit nga akti i regjistrimit të shoqatës.

(3) Nëse lista zgjedhore paraqitet nga partia politike e pakicës kombëtare, ajo është e detyruar të vendosë emrin e saj si propozues të listës zgjedhore sipas emrit nga akti i regjistrimit të partisë politike.

Emri i listës zgjedhore

Neni 22

(1) Lista zgjedhore mban emrin e caktuar nga propozuesi i listës zgjedhore.

(2) Nëse lista zgjedhore propozohet nga grupi i votuesve, emri i listës zgjedhore duhet të përmbajë emrin e caktuar në marrëveshjen për formimin e grupit të votuesve. Emri i listës zgjedhore të grupit të votuesve nuk duhet të përmbajë fjalët “shoqatë” dhe “parti” në asnjë rasë, as emrin e shoqatës ose partisë së regjistruar politike.

(3) Nëse lista zgjedhore propozohet nga shoqata, emri i listës zgjedhore mund të përmbajë emrin e shoqatës i cili shënohet sipas emrit të shoqatës nga akti i regjistrimit të saj.

(4) Nëse lista zgjedhore propozohet nga partia politike e pakicës kombëtare, emri i listës zgjedhore duhet të përmbajë emrin e partisë politike nga akti i regjistrimit të saj.

(5) Emri i listës zgjedhore të propozuar nga grupi i votuesve ose shoqata nuk mund të implikojë emrin e kishës ose komunitetit fetar.

(6) Në emrin e listës zgjedhore mund të përfshihet edhe emri dhe mbiemri i një personi (mbartësi i listës zgjedhore), me pëlqimin e atij personi, në formularin e parashikuar nga Komisioni.

(7) Si përjashtim nga paragrafi 6 të këtij neni, nënshkrimi i listës zgjedhore, autorizimit për paraqitjen e listës zgjedhore ose marrëveshjes për formimin e grupit të votuesve, do të konsiderohet si dhënia e pëlqimit që emri i këtij personi të përdoret në emrin e listës zgjedhore.

(8) Emri i listës zgjedhore mund të përmbajë së bashku me emrin e bartësit të listës zgjedhore edhe nofkën e tij ose pseudonimin e tij të njohur gjerësisht.

(9) Bartësi i listës mundet, por nuk është e thënë të jetë kandidat për anëtarin e këshillit kombëtar në atë listë zgjedhore.

(10) I njëjti person nuk mund të jetë bartës i dy listave zgjedhore, as nuk mund të jetë bartës i një liste zgjedhore, dhe kandidat për anëtar të këshillit kombëtar në listën tjetër zgjedhore.

(11) Emri i listës zgjedhore nuk mund të përmbajë emrat e figurave historike apo imagjinare.

(12) Emri i listës zgjedhore jepet në gjuhën serbe dhe alfabetin cirilik, dhe mund të jepet edhe në gjuhën dhe alfabetin e pakicës kombëtare.

Dokumentacioni që dorëzohet me listën zgjedhore

Neni 23

(1) Listës zgjedhore i bashkëngjitet dokumentacioni në vijim:

1) deklarata e çdo kandidati për pranimin e kandidaturës për anëtar të këshillit kombëtar, në formularin e parashikuar nga Komisioni, i cili përmban emrin e tij, mbiemrin, JMBG, profesionin, vendin dhe adresën e banimit, të vulosur te noteri publik ose në administratën e komunës ose qytetit, ndërsa në komuna ose qytete ku nuk janë emëruar noterët publikë mund të vuloset edhe pranë Gjykatës Themelore, njësisë gjyqësore ose zyrës së pranimit të Gjykatës Themelore;

2) pëlqimi i mbartësit të listës zgjedhore për t'u emëruar mbartës i listës zgjedhore, në formularin e parashikuar nga Komisioni që përmban, emrin, mbiemrin, JMBG, vendin dhe adresën e banimit, nëse emri i listës zgjedhore përmban emrin dhe mbiemrin e këtij personi fizik dhe nëse ai nuk e ka

nënshkruar listën zgjedhore, autorizimi për paraqitjen e listës zgjedhore ose marrëveshja për themelimin e grupit të votuesve;

3) autorizimi i personit të autorizuar nga propozuesi që të paraqesë listën zgjedhore, në formularin e parashikuar nga Komisioni, që përmban emrin, mbiemrin, JMBG, vendin dhe adresën e banimit të personit të autorizuar, nëse lista zgjedhore nuk paraqitet nga përfaqësuesi i grupit të votuesve, shoqatës ose partisë politike të pakicës kombëtare;

4) deklaratat e votuesve për mbështetjen e listës zgjedhore, në formularin e parashikuar nga Komisioni, i cili përmban emrin, mbiemrin, JMBG, vendin dhe adresën e banimit për çdo votues, të vulosura para skadimit të afatit për paraqitjen e listës zgjedhore te noteri publik ose në administratën e komunës ose qytetit, ndërsa në komuna ose qytete ku nuk janë emëruar noterët publikë mund të vuloset edhe pranë Gjykatës Themelore, njësisë gjyqësore ose zyrës së pranimit të Gjykatës Themelore;

5) lista e votuesve që mbështesin listën zgjedhore, e hartuar në formë të shkruar dhe elektronike (CD, DVD ose USB), në mënyrë që lista të jetë identike në të dy forma, e nënshkruar nga personi i cili paraqet listën zgjedhore, në formularin e parashikuar nga Komisioni, që përmban emrin dhe mbiemrin e votuesit, JMBG-në e tij dhe të dhënat për organin që ka vulosur nënshkrimet në deklaratë;

6) marrëveshja e vulosur për formimin e grupit të votuesve nëse lista zgjedhore paraqitet nga grupi i votuesve;

7) kopja e vulosur e statutit të shoqatës, e dorëzuar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve, nëse lista propozohet nga një shoqatë.

(2) Deklaratat e votuesve për mbështetjen e listës zgjedhore dhe lista e atyre votuesve duhet të renditen sipas rendit alfabetik të komunës/qytetit në territorin e të cilit janë vulosur deklaratat, dhe në kuadër të komunës/qytetit duhet të renditen sipas organit të autorizuar për vulosje.

(3) Formularët për paraqitjen e listës zgjedhore caktohen nga Komisioni me një akt të veçantë dhe publikohen brenda pesë ditëve nga miratimi i vendimit për shpalljen e zgjedhjeve.

Mbledhja e nënshkrimeve të votuesve të cilët mbështesin listën zgjedhore

Neni 24

(1) Lista zgjedhore duhet të mbështetet nga të paktën 1% dhe jo më pak se 50 votues të regjistruar në listën e veçantë të votuesve të pakicës kombëtarë këshilli kombëtar i së cilës është duke u zgjedhur.

(2) Vendimi i ministrisë kompetente për listën e veçantë të votuesve për caktimin e përkohshëm të listës së veçantë të votuesve është kompetent për përcaktimin e numrit më të vogël të nënshkrimeve të votuesve të duhura për mbështetjen e listës zgjedhore. Komisioni në ueb-faqen e tij publikon në kohë informacionin për numrin më të vogël të deklaratave të votuesve të duhura për paraqitjen e listës zgjedhore të kandidatëve për anëtarët e të gjitha këshillave kombëtarë të pakicave kombëtare që zgjidhen në zgjedhjet e drejtpërdrejta.

(3) Votuesi me nënshkrimin e tij mund të mbështesë listën zgjedhore të vetëm një propozuesi.

(4) Deklarata e vulosur e votuesit se mbështet listën zgjedhore është e plotfuqishme edhe kur janë bërë gabime gjatë plotësimit të formularit

nëse mund të konstatohet me siguri se cila listë zgjedhore është mbështetur dhe se deklarata është vulosur nga organi kompetent.

(5) Ndalohet mbledhja e nënshkrimeve të mbështetjes nga votuesit në vendin e tyre të punës ose të bëhet çfarëdo lloj presioni ndaj votuesit për të mbështetur me nënshkrimin e tij ndonjë listë zgjedhore.

Komisioni, jo më vonë se shtatë ditë para ditës së votimit, publikon në ueb-faqe për secilën listë të shpallur zgjedhore, numrin e deklaratave të vulosura të votuesve që kanë mbështetur me nënshkrimet e tyre atë listë zgjedhore sipas njërive të vetëqeverisjes lokale, me të dhënat rreth numrit të deklaratave të vulosura në kuadër të çdo njësie të vetëqeverisjes lokale nga secili prej noterëve të autorizuar (noteri publik, administrata komunale, përkatësisht e qytetit ose gjykata themelore, njësia gjyqësore ose zyra e pranimit në gjykatën themelore).

Mangësitë e listës zgjedhore

Neni 25

(1) Kur Komisioni përcakton se lista zgjedhore nuk është paraqitur në kohë, merret vendimi për refuzimin e listës zgjedhore.

(2) Kur Komisioni përcakton se lista zgjedhore përmban mangësitë që pamundësojnë shpalljen e listës zgjedhore, brenda 24 orëve nga pranimi i listës zgjedhore merret konkluzioni me të cilin i urdhërohet propozuesit të listës zgjedhore që të heqë këto mangësitë brenda 48 orëve nga dorëzimi i konkluzionit. Në konkluzion, paraqitësit të listës zgjedhore i tregohet mënyra për heqjen e mangësive.

(3) Kur Komisioni e konstaton se lista zgjedhore përmban mangësi, ose kur konstaton se mangësitë nuk janë hequr ose nuk janë hequr brenda afatit të parashikuar, në 48 orë të ardhshme merret vendimi për refuzimin e shpalljes së listës zgjedhore.

Shpallja e listës zgjedhore

Neni 26

(1) Komisioni e shpall listën zgjedhore të propozuesit menjëherë pas pranimit të listës zgjedhore dhe dokumentacionit shoqërues, dhe jo më vonë se brenda 24 orëve nga pranimi i listës zgjedhore.

(2) Komisioni, pa vonesë, ia dorëzon propozuesit vendimin për shpalljen e listës zgjedhore nga paragrafi 1 i këtij neni.

(3) Propozuesi i listës së shpallur zgjedhore mund të tërheqë listën zgjedhore jo më vonë se ditën e caktimit të listës përmbledhëse zgjedhore.

Ndërprerja e procedurës së zgjedhjes së anëtarëve të këshillit kombëtar

Neni 27

(1) Nëse për zgjedhjet e anëtarëve të një këshilli të caktuar kombëtar nuk aplikon asnjë listë zgjedhore, nëse asnjë listë e aplikuar zgjedhore nuk shpallet ose nëse numri i kandidatëve në listat e shpallura zgjedhore është më i ulët sesa numri i anëtarëve të këshillit kombëtar i cili është duke u zgjedhur, Komisioni merr vendimin për ndërprerjen e procedurës së zgjedhjes së anëtarëve të atij këshillit kombëtar..

(2) Kur vendimi për ndërprerjen e procedurës së zgjedhjes së anëtarëve të këshillit kombëtar bëhet i formës së prerë, Komisioni ia komunikon atë ministrisë kompetente për të drejtat e njeriut dhe të pakicave.

IV LISTA PËRMBLEDHËSE ZGJEDHORE

Neni 28

(1) Lista përmbledhëse zgjedhore për zgjedhjen e çdo këshilli kombëtar veç e veç, përmban të gjitha listat zgjedhore me emrat personal të të gjithë kandidatëve dhe të dhënat për vitin e lindjes, profesionin dhe vendbanimin.

(2) Renditja e listave zgjedhore në listën përmbledhëse zgjedhore përcaktohet sipas renditjes së shpalljes së tyre.

(3) Komisioni cakton listat përmbledhëse zgjedhore të kandidatëve për anëtarët e çdo këshilli kombëtar veç e veç dhe i publikon atë në "Fletoren Zyrtare të Republikës së Serbisë", jo më vonë se dhjetë ditë para mbajtjes së zgjedhjeve.

(4) Komisioni nuk do të përcaktojë listën përmbledhëse zgjedhore nëse numri i kandidatëve në listat e shpallura zgjedhore është më i ulët sesa numri i anëtarëve të këshillit kombëtar i cili është duke u zgjedhur.

V VENDVOTIMET

Kompetenca për përcaktimin e vendvotimeve

Neni 29

(1) Komisioni cakton dhe publikon në "Fletoren Zyrtare të Republikës së Serbisë" vendvotimet në të cilat do të votohet në zgjedhjet, jo më vonë se 20 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

(2) Komisioni cakton vendvotimet në bashkëpunim me organet e administratës së komunës/qytetit, ose organet e administratës së komunave të qytetit të Beogradit (në tekstin e mëtejshëm: administrata e komunës/qytetit)

Mënyra e caktimit të vendvotimeve

Neni 30

(1) Vendvotimi caktohet për votimin e së paku 100, dhe jo më shumë se 2.500 votues.

(2) Në raste të jashtëzakonshme, mund të caktohet vendvotimi për më pak se 100 votues, nëse votimi, për shkak të distancës ose pozitës së pafavorshme gjeografike, do të ishte i vështirësuar konsiderueshëm në një vendvotim tjetër.

(3) Vendvotimi mund të përfshijë edhe territorin e një ose më shumë njësive të vetëqeverisjes lokale, një pjesë të vendbanimit, një vendbanim ose disa vendbanime.

(4) Për çdo vendvotim caktohet: numri i vendvotimit, emri i vendvotimit, adresa e vendvotimit dhe zona nga e cila votojnë votuesit në atë vendvotim (komuna, qyteti, komunë qyteti, rruga, numri i shtëpisë, fshati, katundi, vendbanimi etj.).

Objektet ku ndodhen vendvotimet

Neni 31

(1) Si vendvotime caktohen ambientet në objektet publike, dhe vetëm në raste të jashtëzakonshme edhe ambientet në objektet private.

(2) Propozimi i administratës së komunës/qytetit që vendvotimi të jetë në një objekt privat duhet të arsyetohet.

(3) Si vendvotim nuk mund të caktohet ambienti në objektin fetar, objekti në pronësi të një partie politike ose objekti që përdoret nga një parti politike, si dhe objekti në pronësi të një kandidati për anëtar të këshillit kombëtar ose të një anëtari të familjes së tij.

(4) Të gjitha objektet në të cilat gjenden ambientet e përcaktuara si vendvotime, pa marrë parasysh nëse janë në pronësi publike ose private, konsiderohen gjatë votimit si objekte në përdorim publik në kuptimin e ligjit që rregullon lëvizje me ndihmën e qenit guidë.

Sipërfaqja e ambientit të votimit

Neni 32

(1) Ambienti që caktohet për vendvotim me më pak se 1.000 votues duhet të jetë me sipërfaqe jo më pak se 30 metra katrorë.

(2) Ambienti që caktohet për vendvotim me 1.000 votues dhe më shumë, duhet të jetë me sipërfaqe jo më pak se 50 metra katrorë.

Qasshmëria e qendrave të votimit

Neni 33

(1) Gjatë caktimit të vendvotimit, do të mbahet parasysh fakti që vendvotimi duhet të jetë i qasshëm (në kuptimin fizik dhe atë të komunikimit).

(2) Qasshmëria nënkupton që kalimi deri te objekti ku ndodhet një ose disa vendvotime dhe kalimi i këmbësorëve të jenë pa pengesa, që të ketë vende parkimi për personat me aftësi të kufizuara, që hyrja në objekt të jetë në nivelin e trotuarit ose të ketë një mënyrë të përshtatshme për përballimin e pengesave, që dera në objekt të mundësojë hyrje të lehtë, që të mundësohet lëvizja brenda objektit në një nivel ose të ketë mundësi për komunikim të papenguar vertikal, si dhe që të sigurohen format e informacioneve dhe komunikimit me votues.

(3) Si vendvotime, kudo që është e mundur, caktohen ambientet në katin përdhe të objektit ku ndodhet vendvotimi.

Rregullimi i vendvotimeve

Neni 34

(1) Organi i punës, në bashkëpunim me administratën e komunës/qytetit, është i detyruar të sigurojë në kohë që ambientet e votimit të rregullohen në mënyrën e parashikuar në ligj, rregullat e punës së vendvotimeve dhe këtë udhëzim, dhe të jenë të hapura për votim.

(2) Ambienti i votimit duhet të rregullohet në mënyrë që të sigurojë fshehtësinë e votimit, në përputhje me rregullat e punës së këshillave të vendvotimit.

(3) Vendvotimi duhet të jetë i rregulluar në mënyrë që të mundësohet qasja dhe lëvizja e papenguar të votuesve me aftësi të kufizuara.

(4) Në vendvotim dhe 50 metra rreth vendvotimit ndalohet shpalosja e simboleve të propozuesve të listave zgjedhore dhe të materialeve të tjera zgjedhore propagandistike.

(5) Këshilli i vendvotimit do t'u sigurojë personave që mbikëqyrin, pse ndjekin punën e këshillit të vendvotimit (përfaqësuesve të propozuesve të listave të shpallura zgjedhore dhe vëzhguesve) një vend të përshtatshëm nga i cili mund të ndjekin ecurinë e votimit dhe përcaktimin e rezultateve të votimit.

VI LISTAT E VEÇANTA TË VOTUESVE

Regjistrimi dhe ndryshimet në listën e veçantë të votuesve

Neni 35

(1) Administrata e komunës/qytetit kompetente për përditësimin e një pjesë të listës së veçantë të votuesve të një pakice të caktuar kombëtare, kryen regjistrimin e votuesve të peregjistruar në listën e veçantë të votuesve, si dhe ndryshimin e të dhënave në listën e veçantë të votuesve, deri në mbylljen e saj, pra jo më vonë se 15 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve.

(2) Nga mbyllja e listave të veçanta të votuesve të pakicave kombëtare (në tekstin e mëtejshëm: lista e votuesve), deri në 72 orë para ditës së zgjedhjeve, regjistrimi i votuesve të peregjistruar në listën e votuesve dhe ndryshimet në listën e votuesve kryhen nga ministria kompetente për listën e votuesve.

Mbyllja e listës së votuesve dhe publikimi i numrit total të votuesve

Neni 36

(1) Ministria kompetente për listën e votuesve e mbyll listën zgjedhore me vendim, 15 ditë para ditës së zgjedhjeve dhe në vendim caktohet numri total i votuesve për çdo pakicë kombëtare, si dhe numri i votuesve sipas vendvotimeve, përgjithësisht për çdo vendvotim dhe sipas pakicave kombëtare.

(2) Vendimi për mbylljen e listës së votuesve publikohet nga ministria kompetente për listën e votuesve në "Fletoren Zyrtare të Republikës së Serbisë" brenda 24 orëve nga miratimi dhe i dorëzohet Komisionit.

Dorëzimi i ekstraktit nga lista e votuesve

Neni 37

Ministria kompetente për listën e votuesve përpilon ekstraktet e vulosura nga lista e votuesve për çdo vendvotim dhe çdo pakicë kombëtare dhe ua dorëzon ato Komisionit brenda 48 orëve nga mbyllja e listës së votuesve.

Dorëzimi i vendimit për ndryshimet e mëvonshme në listën zgjedhore

Neni 38

Ministria kompetente për listën e votuesve ia dorëzon Komisionit të gjitha vendimet mbi të cilat bazohen ndryshimet në listën e votuesve, që janë marrë nga mbyllja e listës së votuesve deri në 72 orë para ditës së zgjedhjeve.

Hedhja e të dhënave nga vendimi për ndryshimet e mëvonshme në listën zgjedhore

Neni 39

(1) Komisioni, në bazë të vendimeve të ministrisë kompetente për listën e votuesve mbi të cilat bazohen ndryshimet në listën e votuesve, hedh ndryshimet në ekstraktet nga lista e votuesve, duke marrë parasysh vetëm vendimet e pranuar jo më vonë se 48 orë para ditës së zgjedhjeve.

(2) Regjistrimi i ndryshimeve në ekstraktin nga lista e votuesve bëhet sipas të dhënave nga vendimet mbi të cilat bazohen ndryshimet në listën e votuesve, duke filluar nga numri rendor 1, në fund të ekstraktit nga lista e votuesve, në një faqe të veçantë që quhet: „Ndryshimet e mëvonshme”.

Përcaktimi dhe publikimi i numrit total të votuesve

Neni 40

Komisioni, pas hedhjes së ndryshimeve nga neni 38 i këtij udhëzimi, përcakton dhe publikon në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Serbisë” numrin total të votuesve për çdo pakicë kombëtare, si dhe numrin e votuesve sipas vendvotimeve, dhe numrin total për çdo vendvotim dhe sipas pakicave kombëtare.

VII NJOFTIMI PËR DITËN DHE ORËN E MBAJTJES SË ZGJEDHJEVE

Neni 41

(1) Administrata e komunës/qytetit ua dorëzon votuesve njoftimin për ditën dhe orën e zgjedhjeve, me numrin dhe adresën e vendvotimit në të cilin voton votuesi, dhe numrin me të cilin është regjistruar votuesi në ekstraktin nga lista e votuesve.

(2) Dorëzimi i njoftimit nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet jo më vonë se pesë ditë para ditës së zgjedhjeve.

VIII STANDARDET PËR MATERIALIN ZGJEDHOR

Printimi i materialit zgjedhor

Neni 42

(1) Fletëvotimet dhe materialet e tjera zgjedhore printohen në shtypshkronjën e Kompanisë publike “Fletorja Zyrtare” .

(2) Fletëvotimet e zgjedhjeve printohen në një letër të mbrojtur me shenjën ujore.

(3) Komisioni përcakton ngjyrën e fletëvotimit dhe fletës kontrolluese për kontrollin e saktësisë së kutisë së votimit dhe i publikon ato në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Serbisë”.

(4) Fletëvotimi dhe fleta kontrolluese për kontrollin e saktësisë së kutisë së votimit nuk mund të jenë me të njëjtën ngjyrë.

Fletëvotimet

Neni 43

(1) Numri i fletëvotimeve që printohen duhet të jetë i barabartë me numrin e votuesve të regjistruar në listën e votuesve për çdo pakicë kombëtare këshilli kombëtar i së cilës është duke u zgjedhur.

(2) Komisioni me vendim përcakton numrin e fletëvotimeve që do të printohen, si dhe numrin e fletëvotimeve rezervë.

(3) Numri i fletëvotimeve rezervë për çdo këshill kombëtar nuk mund të jetë më i lartë se 0,5% të numrit total të votuesve të çdo pakice kombëtare, dhe nuk mund të jetë më i ulët se 10, duke marrë parasysh se ky numër mund të jetë edhe më i madh, në përputhje me numrin total të votuesve të përcaktuar nga Komisioni.

(4) Komisioni përcakton me vendim formën dhe pamjen e fletëvotimeve, dhe pjesa përbërëse e këtij vendimi është edhe mostra e fletëvotimit.

Përdorimi i gjuhëve dhe alfabeteve

Neni 44

(1) Teksti i formularit për paraqitjen e listës zgjedhore, teksti i listës përmbledhëse zgjedhore, teksti i fletëvotimit, teksti i formularit të procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit dhe teksti i vërtetimit për zgjedhjen e anëtarit të këshillit kombëtar të pakicës kombëtare printohen në gjuhën serbe dhe alfabetin cirilik.

(2) Nëse gjuha dhe alfabeti i pakicës kombëtare këshilli kombëtar i së cilës është duke u zgjedhur janë në përdorim zyrtar në jo më pak se një njësi të vetëqeverisjes lokale, tekstet e materialeve nga paragrafi 1 i këtij neni do të printohen në dy gjuhë, pra edhe në gjuhën dhe alfabetin e pakicës kombëtare, në mënyrë që teksti në gjuhën dhe alfabetin e pakicës kombëtare të printohet poshtë tekstit në gjuhën serbe dhe alfabetin cirilik, në të njëjtën formë dhe me të njëjtën madhësi shkronjash.

Përgatitja për printimin e fletëvotimeve

Neni 45

(1) Pas marrjes së vendimit për formën dhe pamjen e fletëvotimeve, Komisioni përpilon mostrën e fletëvotimit e cila vuloset nga kryetari i Komisionit me nënshkrimin e tij dhe vulën e Komisionit.

(2) Në bazë të mostrës së vulosur të fletëvotimit, shtypshkronja përgatitet për printimin e fletëvotimeve.

(3) Kopjet e para të fletëvotimeve asgjësohen në vendngjarje gjithnjë derisa të printohet një fletëvotim i cili përmbush standardet e nevojshme grafike.

(4) Fletëvotimet e para të printuara që përmbushin standardet e nevojshme grafike krahasohen me mostrën e vulosur të fletëvotimit nga kryetari i Komisionit ose personi tjetër i autorizuar nga ai.

(5) Pasi ka konstatuar që kopja e printuar e fletëvotimit përputhet me mostrën e vulosur, kryetari i Komisionit ose personi i autorizuar nga ai me

nënshkrimin e vet, miraton printimin e fletëvotimeve në një numër të caktuar të kopjeve.

(6) Menjëherë pas përfundimit të printimit, në prani të së paku tre anëtarëve të autorizuar, përkatësisht të zëvendës anëtarëve të Komisionit, të emëruar me propozim të propozuesve të ndryshëm të autorizuar, asgjësohen të gjitha fletëvotimet e tepërta, si dhe i gjithë materiali i përdorur për përgatitjen e printimit të fletëvotimeve, dhe për këtë përpilohet procesverbali.

Mbikëqyrja e printimit

Neni 46

(1) Printimi i fletëvotimeve mbikëqyret nga Komisioni.

(2) Komisioni është i detyruar të mundësojë që procesi i printimit të fletëvotimeve të jetë publik.

(3) Përfaqësuesit e propozuesve të listave zgjedhore dhe përfaqësuesit e akredituar të vëzhguesve vendas dhe të huaj kanë të drejtë të marrin pjesë në printimin, numërimin dhe paketimin e fletëvotimeve dhe dorëzimin e tyre në Komision, organet e punës dhe këshillat e vendvotimit.

(4) Komisioni është i detyruar t'i njoftoj në kohë propozuesit e listave zgjedhore dhe vëzhguesit vendas dhe të huaj që përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë të jenë të pranishëm gjatë printimit, numërimit, paketimit dhe dorëzimit të fletëvotimeve, si dhe për vendin dhe kohën e zhvillimit të këtyre veprimeve.

(5) Personi i autorizuar i propozuesit të listës zgjedhore i dërgon Komisionit me shkrim njoftimin për personat që do të jenë të pranishëm gjatë printimit, numërimit dhe paketimit të fletëvotimeve, në të cilin shënohet emri dhe mbiemri, numri i letërnjoftimit dhe numri i celularit për çdo person.

(6) Përfaqësuesit e propozuesve të listave zgjedhore, të cilët marrin pjesë në dorëzimin e fletëvotimeve në Komisionin dhe në dorëzimin e fletëve të votimit në organet e punës, përkatësisht këshillat e vendvotimit, duhet të kenë autorizim për të marrë pjesë në këto veprime, i cili përmban emrin dhe mbiemrin e përfaqësuesit, numrin e letërnjoftimit dhe numrin e telefonit celular.

(7) Kompania publike "Fletorja Zyrtare" është e detyruar të mbajë evidencë për praninë e përfaqësuesve të propozuesve të listave zgjedhore dhe vëzhguesve vendas e të huaj gjatë printimit, numërimit dhe paketimit të fletëve të votimit.

Kutia e votimit dhe paravanet për sigurimin e fshehtësisë së votimit

Neni 47

Për votimin në zgjedhje përdoret kutia e votimit dhe paravanet për sigurimin e fshehtësisë së votës, të bëra sipas Udhëzimit për standardet unike të materialeve zgjedhore ("Fletorja Zyrtare e RS", numër 19/22).

Spreji për shënimin e gishtit të votuesit

Neni 48

Shënimi i gishtit të votuesit si shenjë që votuesi ka votuar bëhet me sprejin me ngjyrë të patretshme UV, e cila shihet nën dritën e veçantë të llambës UV.

IX DORËZIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR NË KËSHILLAT E VENDVOTIMIT PARA VOTIMIT

Materiali zgjedhor i siguruar nga Komisioni

Neni 49

(1) Komisioni siguron materialet e mëposhtme zgjedhore për çdo këshill të vendvotimit:

1) listën përmbledhëse zgjedhore të kandidatëve për anëtarë të çdo këshilli kombëtar që zgjidhet në vendvotim;

2) ekstraktin nga lista e votuesve për votim në vendvotim për çdo këshill kombëtar që zgjidhet në vendvotim;

3) numrin e kërkuar të fletëve të votimit, që përputhet me numrin e votuesve të regjistruar në ekstraktin nga pika 2) e këtij paragrafi;

4) Fletën kontrolluese për verifikimin e saktësisë së kutisë së votimit;

(5) Procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit për zhvillimin e votimit në zgjedhjet për anëtarët e çdo këshilli kombëtar që zgjidhet në qendrën e votimit (në tekstin e mëtejshëm: procesverbali i punës së këshillit të vendvotimit), në gjashtë kopje;

6) Formulari kontrollues për përshtatjen logjiko-llogaritëse të rezultateve të votimit në vendvotim;

7) formulari i Procesverbalit për vëzhguesit e punës së këshillit të vendvotimit;

8) Flamurin popullor të Republikës së Serbisë;

9) formularët e vërtetimeve për të drejtën zgjedhore për votim jashtë vendvotimit;

10) vendimin për themelimin e këshillit të vendvotimit;

11) kartat identifikuese për anëtarët e këshillave të vendvotimit;

12) Formularët e evidencës mbi praninë e anëtarëve dhe zëvendës anëtarëve të këshillit të vendvotimit në vendvotim, *në dy kopje*;

13) listën e përfaqësuesve të propozuesve të listave zgjedhore për mbikëqyrjen e punës së këshillave të vendvotimit;

14) listën e përfaqësuesve të vëzhguesve vendas dhe të huaj të akredituar për monitorimin e punës së këshillave të vendvotimit;

15) shenjën e vendvotimit, posterat informues për votues, udhëzuesin etj.;

16) kutinë e votimit, shenjën e kutisë së votimit dhe dy stikera për vulosjen e kutisë së votimit;

17) paravanet për sigurimin e fshehtësisë së votimit;

18) Dy spreja për shënimin e gishtit të votuesit;

19) dy llamba UV;

20) thesin për materialin zgjedhor, lidhëse të sigurisë për mbylljen e thesit dhe stikerin për shënimin e thesit;

21) zarfet për paketimin e fletëvotimeve dhe stikerat për vulosjen e zarfeve.

(2) Nëse materiali nga paragrafi 1 pika 9) e këtij neni, që dorëzohet nga Komisioni për organin e punës, nuk është i mjaftueshëm, organi i punës e shumon deri në numrin e duhur të kopjeve.

(3) Materialet nga paragrafi 1. pika 13) dhe 14) e këtij, shumohen nga organi i punës deri në numrin e duhur të kopjeve.

Materiali zgjedhor që sigurohet nga administrata e komunës/qytetit)

Neni 50

(1) Administratat e komunës/qytetit për çdo këshill të vendvotimit sigurojnë materialet në vijim:

- 1) bateritë për llamba UV;
- 2) Pajisje shkrimi (stilolapsa, flomastra etj.);
- 3) zarfet për ruajtjen e fletëvotimeve dhe vërtetimeve për të drejtën zgjedhore për të votuar jashtë vendvotimit, pas votimit;
- 4) materialet e tjera (gërshëra, shirit ngjites, pe, vizore, letra etj).

(2) Administratat e komunës/qytetit janë të detyruara të sigurojnë hapësirën për ruajtjen e sigurt të materialit zgjedhor.

Dorëzimi i materialit zgjedhor përmes organit të punës

Neni 51

(1) Koordinatori e merr materialin zgjedhor të shtypur nga Kompania Publike "Fletorja Zyrtare" dhe ia dorëzon atë organit të punës jo më vonë se katër ditë para ditës së zgjedhjeve.

(2) Materialin zgjedhor nga neni 49 i këtij udhëzimi koordinatori ia dorëzon organit të punës në selinë e qarkut administrativ, ndërsa për qytetin e Beogradit në shtypshkronjën e Kompanisë Publike "Fletorja Zyrtare".

(3) Për dorëzimin e kryer nga paragrafi (2) i këtij neni, përpilohet procesverbal në tri kopje në formularin e përcaktuar nga Komisioni.

(4) Organi i punës, jo më vonë se 48 orë para ditës së zgjedhjeve ia dorëzon këshillave të vendvotimit në selinë e komunës/qytetit materialin e pranuar, së bashku me materialin nga neni 50 i këtij udhëzimi, të cilin e ka siguruar administrata e komunës/qytetit. Për dorëzimin e kryer të materialit zgjedhor përpilohet procesverbal në tri kopje në formularin e përcaktuar nga Komisioni.

(5) Pas dorëzimit të materialeve zgjedhore në këshillat e vendvotimit, materialet zgjedhore vendosen në thes për materialin zgjedhor, i cili vulozet me vulë sigurie në prani të anëtarëve të organit të punës dhe të këshillit të vendvotimit, numri rendor i të cilit shënohet në procesverbalin e dorëzimit nga paragrafi 4 i këtij neni.

(6) Para vulosjes, thesi me materiale zgjedhore duhet të shënohet me stiker që përmban emrin e qytetit/komunës dhe numrin rendor të vendvotimit.

(7) Thasët e vulosur me materialin zgjedhor nuk duhet të hapen para se të mbliidhet këshilli i vendvotimit në ditën e votimit në vendvotim.

Rregullat e veçanta për paketimin dhe dorëzimin e fletëvotimeve

Neni 52

(1) Nëse në një qendër votimi votojnë më shumë se 100 votues të një pakice kombëtare, gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore, fletëvotimet për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit kombëtar të asaj pakice kombëtare duhet t'i dorëzohen këshillit të vendvotimit duke paketuar fillimisht nga 100 fletëvotime në zarf të veçantë dhe në fund fletët e mbetura që janë më pak se 100 vihen në një zarf të veçantë (për shembull, nëse në qendrën e votimit janë regjistruar 436 votues të një pakice kombëtare, organi i punës vendos nga 100 fletëvotime në katër zarfe dhe më pas 36 fletëvotime të mbetura në zarfin e pestë).

(2) Në rastin e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, të gjitha zarfet me fletëvotime duhet të mbyllen dhe të vulosen me një stiker që përmban emrin e pakicës kombëtare dhe në të cilin shënohet numri i fletëvotimeve në atë zarf, dhe kështu të vendosen në një thes për ruajtjen e materialeve zgjedhore.

(3) Organi i punës duhet t'u theksojë këshillave të vendvotimit:

1) që gjatë përgatitjes për fillimin e votimit në vendvotim të hapen vetëm zarfe me më pak se 100 fletëvotime për votuesit e pakicës kombëtare me më shumë se 100 votues;

2) se zarfi me 100 fletëvotime nuk mund të hapet derisa të përdoren për votim të gjitha fletëvotimet nga zarfi i parë i hapur;

3) që zarfi i radhës me 100 fletëvotime të hapet vetëm pasi të jenë përdorur të 100 fletëvotime nga zarfi i hapur më parë me 100 fletëvotime;

4) që të gjitha zarfet që nuk ka pasur nevojë të hapen gjatë votimit duhet të mbeten të vulosura dhe në këtë mënyrë t'i dorëzohen organit të punës pas votimit.

(4) Zarfet për paketimin e fletëve të votimit dhe stikerat për vulosjen e zarfeve sigurohen nga Komisioni dhe u dorëzohen organeve të punës së bashku me materialin nga neni 49 i këtij udhëzimi.

X DORËZIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR NË KOMISION PAS VOTIMIT

Dorëzimi i materialit zgjedhor përmes organit të punës

Neni 53

(1) Pas përcaktimit të rezultateve të votimit në vendvotim, këshilli i vendvotimit pa vonesë ia dorëzon trupit punues në ndërtesën e komunës/qytetit materialin zgjedhor në vijim:

1) kopjen e parë të procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit në zbatimin e votimit dhe përcaktimin e rezultateve të votimit në zgjedhjet për anëtarët e çdo këshilli kombëtar që zgjidhet në qendrën e votimit;

(2) formularin e Procesverbalit për vëzhguesit e punës së këshillit të vendvotimit;

3) ekstraktin nga lista e votuesve sipas së cilës është bërë votimi në vendvotim për zgjedhjet për anëtarët e çdo këshilli kombëtar;

4) zarfin në të cilin gjendet Fleta kontrolluese për verifikimin e saktësisë së kutisë së votimit i vulosur me stiker;

5) zarfin me fletëvotime të papërdorura për votim në zgjedhjet për anëtarët e secilit këshilli kombëtar që zgjidhet në qendrën e votimit, të vulosur me stiker të veçantë;

6) zarfin me fletëvotime të pavlefshme për votim në zgjedhjet për anëtarët e secilit këshilli kombëtar që zgjidhet në qendrën e votimit, të vulosur me stiker të veçantë;

7) zarfin me fletëvotime të vlefshëm për votim në zgjedhjet për anëtarët e secilit këshilli kombëtar që zgjidhet në qendrën e votimit, të vulosur me stiker të veçantë;

8) zarfin që përmban vërtetime të nënshkruara për të drejtën zgjedhore për të votuar jashtë qendrës së votimit për votim në zgjedhjet për anëtarët e çdo këshilli kombëtar, të vulosur me stiker të veçantë;

9) bllobën e sigurisë të përdorur për vulosjen e thesit me materialin zgjedhor gjatë dorëzimit të materialit zgjedhor midis organit të punës dhe këshillit të vendvotimit para votimit;

10) një kopje të evidencës së pranisë së anëtarëve të këshillit të vendvotimit në vendvotim.

(2) Materiali zgjedhor i dorëzohet nga kryetari i këshillit të vendvotimit ose zëvendësi i tij, dhe të gjithë anëtarët e këshillit të vendvotimit mund të jenë të pranishëm gjatë dorëzimit të materialit zgjedhor.

(3) Për dorëzimin e kryer nga paragrafi 1 i këtij neni, përpilohet procesverbal në katër kopje në formularin e përcaktuar nga Komisioni.

(4) Gjatë dorëzimit nga paragrafi 1 i këtij neni, këshilli i vendvotimit ia dorëzon administratës së komunës/qytetit materialin e mbetur (kutinë e votimit, sprejin për shënimin e gishtave të votuesve, paravanet e votimit, llambat UV, kartat e identifikimit të anëtarëve të këshillit të vendvotimit, kancelari etj.) dhe kopjen tjetër të procesverbalit të pranisë së anëtarëve të këshillit të vendvotimit në vendvotim.

Trajtimi i materialeve të dorëzuara në organin e punës dhe administratën e komunës/qytetit

Neni 54

(1) Pasi këshilli i vendvotimit i ka dorëzuar materialin zgjedhor organit të punës dhe administratës së komunës/qytetit, materiali nga neni 53 paragrafi 1 pikat 4)-7) dhe pika 9) vendoset në thes për materialin zgjedhor, i cili vuloset në prani të anëtarëve të organit të punës dhe të këshillit të vendvotimit me vulë sigurie, numri rendor i së cilës shënohet në procesverbalin e dorëzimit nga neni 53 paragrafi 3 i këtij udhëzimi.

(2) Para vulosjes, thesi me materiale zgjedhore duhet të shënohet me stiker që përmban emrin e qytetit/komunës dhe numrin rendor të vendvotimit. Thesi i vulosur mund të hapet vetëm në bazë të vendimit të Komisionit, përveç në rastin nga neni 55, paragrafi 5 i këtij udhëzimi.

(3) Procesverbali i punës së këshillit të vendvotimit, procesverbali i vëzhguesve të punës së komisionit zgjedhor, ekstrakti nga lista e votuesve dhe zarfi me vërtetimet për të drejtën zarfi me vërtetimet për të drejtën zgjedhore për votim jashtë vendvotimit nuk vendosen në thes bashkë me materiale të tjera zgjedhore, por pakëtohen veçmas nga materialet e tjera zgjedhore dhe kështu i dorëzohen koordinatoriit nga organi i punës.

Neni 55

(1) Organi i punës pas marrjes së materialeve zgjedhore nga të gjitha këshillat e vendvotimit, menjëherë ia dorëzon materialet koordinatorit në selinë e qarkut administrativ.

(2) Organet e punës për qytetin e Beogradit ia dorëzojnë koordinatorit materialet zgjedhore të mbledhura nga të gjitha këshillat e vendvotimit në ndërtesën e Ansamblesë Popullore në Beograd, rruga Kralja Milana 14.

(3) Organi i punës bashkë me materialin zgjedhor të marrë nga këshilli i vendvotimit, ia dorëzon koordinatorit edhe një kopje të procesverbalit të dorëzimit të materialit zgjedhor pas votimit ndërmjet këshillit të vendvotimit dhe organit të punës, si dhe një kopje të evidencës së pranisë së anëtarëve të këshillit të vendvotimit në vendvotim.

(4) Për dorëzimin nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni, procesverbali përpilohet në tri kopje, në formularin e përcaktuar nga Komisioni.

(5) Koordinatori është i autorizuar që ta kontrollojë përmbajtjen e thesit të vulosur me materialet zgjedhore të marrë nga organi i punës, në prani të organit të punës.

(6) Pas kryerjes së kontrollit nga paragrafi 5 i këtij neni, koordinatori në prani të organit të punës e vulos thesin me materialin zgjedhor me lidhëse të re sigurie, numri rendor i së cilës shënohet në procesverbalin e dorëzimit nga paragrafi 4 i këtij neni. Thesi i vulosur mund të rihapet vetëm në bazë të vendimit të Komisionit.

XI PËRCAKTIMI I REZULTATEVE TË ZGJEDHJEVE

Kontrolli i procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit

Neni 56

(1) Gjatë dorëzimit të materialit zgjedhor pas përfundimit të votimit, përfaqësuesit e këshillit të vendvotimit dhe të organit të punës janë të detyruar të kontrollojnë procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit dhe të konstatojnë gabimet eventuale në plotësimin e procesverbalit, si dhe të përpilojnë një raport për këtë.

(2) Nëse gjatë kontrollit të procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit është bërë edhe qasja në materialin zgjedhor, në raportin e kontrollit të procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit shënohet gjendja e faktit e përcaktuar me qasjen në materialin zgjedhor.

Procedura me gabimet e lehta

Neni 57

(1) Nëse në procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit ka gabime të dukshme në plotësimin e këtij procesverbali (gabime të lehta), Komisioni në bazë të raportit për kontrollin e procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit merr vendimin për korrigjimin e procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit.

(2) Gabimet e lehta janë:

1) nëse në procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit nuk është shënuar numri i votuesve të regjistruar në listën e votuesve ose është shënuar numri i gabuar;

2) nëse në procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit nuk është shënuar numri i votuesve që kanë votuar, dhe rezultatet e tjera janë të sakta nga ana logjiko-llogaritëse;

3) nëse në procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit është shënuar numri më i lartë i votuesve që kanë votuar sesa numri i votuesve të regjistruar në ekstraktin nga lista e votuesve dhe rezultatet e tjera janë të sakta nga ana logjiko-llogaritëse;

4) nëse në procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit nuk është shënuar numri total i fletëvotimeve në kutinë e votimit, dhe rezultatet e tjera janë të sakta nga ana logjiko-llogaritëse;

5) nëse në procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit nuk është shënuar numri i fletëvotimeve të vlefshme, dhe shuma e numrit të fletëvotimeve të pavlefshme dhe numrit të votave individuale që ka marrë çdo listë zgjedhore është e barabartë me numrin e fletëvotimeve në kutinë e votimit.

Procedura me gabimet e rënda

Neni 58

(1) Nëse në procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit ka gabime të rënda logjiko-llogaritëse (gabime të rënda), përfaqësuesit e këshillit të vendvotimit dhe të organit të punës janë të detyruar të bëjnë qasje në materialin zgjedhor gjatë kontrollit të procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit.

(2) Komisioni në bazë të raportit për kontrollin e procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit merr vendimin për korrigjimin e procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit, vendimin me të cilin konstatohet se në një vendvotim të caktuar nuk mund të përcaktohen rezultatet e votimit ose vendimin me të cilin anulohet votimi në vendvotim sipas detyrës zyrtare.

(3) Në veçanti, gabimet e rënda janë:

1) Nëse në procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit është shënuar numri më i lartë i fletëvotimeve sesa numri i votuesve që kanë votuar;

2) Nëse në procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit numri i votave që ka marrë çdo listë zgjedhore nuk është i barabartë me numrin e fletëvotimeve të vlefshme, dhe shuma e fletëvotimeve të pavlefshme dhe të vlefshme është e barabartë me numrin e fletëvotimeve në kutinë e votimit;

3) Nëse në procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit shuma e numrit të fletëvotimeve të pavlefshme dhe numrit të votave që ka marrë çdo listë zgjedhore është më e madhe sesa numri i votuesve të regjistruar në ekstraktin nga lista e votuesve;

4) nëse numri i fletëvotimeve të vlefshme të shënuara në procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit nuk është i barabartë me shumën e numrit të votave individuale që ka marrë çdo listë zgjedhore, dhe shuma e fletëvotimeve të pavlefshme dhe të votave individuale që ka marrë çdo listë zgjedhore është e barabartë me numrin e fletëvotimeve në kutinë e votimit;

5) nëse në procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit nuk është shënuar numri i fletëvotimeve të pavlefshme, dhe shuma e numrit të

votave individuale që ka marrë çdo listë zgjedhore është e barabartë ose më e vogël se numri i fletëvotimeve në kutinë e votimit;

6) nëse numri i fletëvotimeve të vlefshme të shënuara në procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit nuk është i barabartë me diferencën e numrit të fletëvotimeve në kutinë e votimit dhe numrit të fletëvotimeve të vlefshme, dhe shuma e numrit të votave individuale që ka marrë çdo listë zgjedhore është e barabartë ose më e vogël se numri i fletëvotimeve në kutinë e votimit.

Pamundësia për të përcaktuar rezultatet e votimit në vendvotim

Neni 59

Komisioni sipas detyrës zyrtare merr vendimin me të cilin konstatohet se në vendvotimin e caktuar nuk mund të përcaktohen rezultatet e votimit:

1) nëse votimi në këtë vendvotim nuk është mbajtur ose nëse është ndërprerë dhe nuk ka vazhduar;

2) nëse nuk marrin procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit;

3) nëse procesverbali i dorëzuar i punës së këshillit të vendvotimit nuk është nënshkruar nga të paktën tre anëtarë të këshillit të vendvotimit;

4) Nëse ka gabime të rënda logjiko-llogaritëse në plotësimin e procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit të cilat nuk mund të korrigjoheshin pas qasjes në tërë materialin zgjedhor nga vendvotimi.

Anulimi i votimit në vendvotim sipas detyrës zyrtare

Neni 60

Komisioni sipas detyrës zyrtare merr vendimin për anulimin e votimit në vendvotim nëse përcaktohet:

1) se numri i fletëvotimeve në kutinë e votimit është më i lartë sesa numri i votuesve që kanë votuar;

2) se këshilli i vendvotimit i ka mundësuar votimin personit i cili nuk është i regjistruar në ekstraktin nga lista e votuesve;

3) se në kutinë e votimit nuk ka fletë kontrolluese, ose që fleta kontrolluese nuk është plotësuar ose nuk është nënshkruar nga votuesi i parë dhe të paktën një anëtar i këshillit të vendvotimit;

4) se shuma e numrit të fletëvotimeve të papërdorura dhe të fletëvotimeve në kutinë e votimit është më e madhe se numri i fletëvotimeve të marra nga këshilli i vendvotimit.

Përsëritja e votimit

Neni 61

(1) Votimi në vendvotim përsëritet nëse konstatohet se në këtë vendvotim nuk mund të përcaktohen rezultatet e votimit ose nëse është anuluar votimi në vendvotim.

(2) Vendimi për votim të përsëritur në vendvotim merret nga Komisioni brenda tre ditëve nga dita e publikimit të vendimit në ueb-faqe me të

cilin konstatohet se në vendvotim mund mund të përcaktohen rezultatet e votimit, ose të vendimit që anulon votimin në këtë vendvotim.

(3) Nëse paraqitet mjeti juridik kundër vendimit me të cilin konstatohet se në vendvotim nuk mund të përcaktohen rezultatet e votimit, ose vendimit me të cilin anulohet votimi në vendvotim, afati për marrjen e vendimit për përsëritjen e votimit në këtë vendvotim llogaritet nga dita kur Komisionit i është dorëzuar vendimi për mjetin juridik.

(4) Votimi i përsëritur zbatohet brenda dhjetë ditëve nga dita e marrjes së vendimit për përsëritjen e votimit.

(5) Komisioni emëron këshillin e ri për zbatimin e votimit të përsëritur.

Rezultatet e zgjedhjeve

Neni 62

(1) Raporti me rezultatet e totale të zgjedhjeve për çdo këshill kombëtar përcaktohet dhe publikohet nga Komisioni në "Fletoren Zyrtare të Republikës së Serbisë" brenda 96 orëve nga momenti i përfundimit të votimit.

(2) Nëse është ushtruar mjeti juridik për shkak të parregullsive gjatë zbatimit të votimit në vendvotim dhe nëse është ushtruar mjeti juridik kundër vendimit i cili konstaton se në vendvotim nuk mund të përcaktohen rezultatet e votimit, ose vendimit me të cilin anulohet votimi në vendvotim, afati për përcaktimin dhe publikimin e raportit me rezultatet totale të votimit llogaritet nga dita kur Komisionit i janë dorëzuar vendimet për të gjitha mjetet e paraqitura juridike.

(3) Nëse në disa vendvotime zbatohet votimi i përsëritur, afati për përcaktimin dhe publikimin e raportit të rezultateve të votimit llogaritet nga mbyllja e vendvotimit të fundit në të cilin është përsëritur votimi, ose nga dita kur Komisionit i janë dorëzuar vendimet për të gjitha mjetet eventuale juridike të paraqitura në lidhje me votimin e përsëritur.

(4) Komisioni Zgjedhor i Republikës gjatë seancës përcakton rezultatet paraprake të zgjedhjeve për të gjitha vendvotimet e përpunuara brenda 24 orëve nga mbyllja e vendvotimeve.

(5) Komisioni në ueb-faqen e tij publikon rezultatet e votimit për çdo këshill kombëtar sipas vendvotimeve.

Publikimi i procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit

Neni 63

(1) Komisioni publikon të gjitha procesverbalet e punës së këshillit të vendvotimit në ueb-faqen e tij.

(2) Nëse është korrigjuar gabimi në plotësimin e procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit, publikohet edhe vendimi për korrigjimin e procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit.

(3) Nëse Komisioni ka marrë vendimin me të cilin konstatohet se në një vendvotim të caktuar nuk mund të përcaktohen rezultatet e votimit ose vendimin me të cilin anulohet votimi në vendvotim, në ueb-faqen bashkë me procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit publikohet edhe ky vendim.

Përpunimi statistikor i të dhënave

Neni 64

(1) Përpunimin statistikor të të dhënave gjatë mbajtjes së zgjedhjeve e kryen organizata kompetente për punët e statistikës në republikë, në bazë të procesverbalit për punën e këshillave të vendvotimit.

(2) Përpunimi i të dhënave statistikore kryhet gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore pas votimit ndërmjet këshillit të vendvotimit dhe organit të punës dhe në selinë e Komisionit.

(3) Organizata përgjegjëse për punët e statistikës në republikë cakton personin i cili pas përfundimit të votimit do të marrë pjesë në dorëzimin e materialeve zgjedhore ndërmjet këshillave të vendvotimit dhe organeve të punës, do të bëjë kontroll logjik dhe llogaritës të të dhënave në procesverbalin e punës së këshillave të vendvotimit, do të marrë pjesë në kontrollin e procesverbaleve të punës së këshillit të vendvotimit dhe do të shënojë në bazën e të dhënave të zgjedhjeve rezultatet e votimit nga procesverbalet e punës së këshillit të vendvotimit, të cilat nuk përmbajnë mangësi formale.

(4) Propozuesi i listës së shpallur zgjedhore mund t'i denoncojë Komisionit personin i cili ka të drejtë të marrë pjesë në përpunimin statistikor të të dhënave në Komision dhe gjatë dorëzimit të materialit zgjedhor pas votimit ndërmjet këshillit të vendvotimit dhe organit të punës.

(5) Menjëherë pas përpunimit statistikor, të dhënat për rezultatet e votimit në vendvotimet publikohen në ueb-faqen e Komisionit, duke filluar nga të dhënat e vendvotimit të parë të përpunuar, deri te publikimi i rezultateve totale të zgjedhjeve.

XII MBIKËQYRJA DHE MONITORIMI I PUNËS SË ORGANEVE DHE AUTORITETEVE PËR ZBATIMIN E ZGJEDHJEVE

Përfaqësuesit e propozuesve të listave të shpallura zgjedhore

Neni 65

(1) Punën e organeve dhe autoriteteve për zbatimin e zgjedhjeve mund ta mbikëqyrin përfaqësuesit e propozuesve të listave të shpallura zgjedhore.

(2) Në seancën e Komisionit, në mbledhjen e grupit punues ose në mbledhjen e organit të punës mund të marrë pjesë vetëm një përfaqësues i propozuesit të listës së shpallur zgjedhore.

(3) Përfaqësuesi i propozuesit të listës zgjedhore mund të mbikëqyrë punën e të gjitha këshillave të vendvotimit në territorin e komunës/qytetit/komunës së qytetit të Beogradit për të cilin ka aplikuar, me kusht që dy përfaqësues të të njëjtit propozuesi të listës zgjedhore nuk mund të jenë të pranishëm në të njëjtin vendvotim në të njëjtën kohë.

(4) Për mbikëqyrjen e punës së organit për zbatimin e zgjedhjeve, propozuesi i listës zgjedhore mund të autorizojë shtetasin madhor të Republikës së Serbisë, i cili nuk është kandidat për anëtar të këshillit kombëtar ose anëtar i autoriteteve dhe organeve të angazhuara në zbatimin e zgjedhjeve.

(5) Përfaqësuesit e propozuesve të listës së shpallur zgjedhore mund të mbikëqyrin punën vetëm të atyre këshillave të vendotimit që zbatojnë zgjedhjet për anëtarë të këshillit kombëtar në të cilat merr pjesë propozuesi i listës së shpallur zgjedhore.

(6) Propozuesi i listës së shpallur zgjedhore e njofton Komisionin për përfaqësuesit e tij të autorizuar për mbikëqyrjen e punës së Komisionit, në formularin e përcaktuar nga Komisioni, jo më vonë se pesë ditë para ditës së zgjedhjeve.

(7) Propozuesi i listës së shpallur zgjedhore e njofton Komisionin për përfaqësuesit e tij të autorizuar për mbikëqyrjen e punës së organeve të punës dhe këshillave të vendotimit sipas komunave/qyteteve/komunave të qytetit të Beogradit, në formularin e përcaktuar nga Komisioni, jo më vonë se dhjetë ditë para ditës së zgjedhjeve.

(8) Komisioni u lëshon akreditimet e përshtatshme përfaqësuesve të propozuesit të listës zgjedhore të autorizuar për mbikëqyrjen e punës së organeve për zbatimin e zgjedhjeve, në të cilat regjistrohen të dhënat e nevojshme të listuara në njoftimin e Komisionit për përfaqësuesit e propozuesit të listës zgjedhore.

(9) Njoftimet e pranuar në kohë nga paragrafi 7 i këtij neni, Komisioni ua dërgon këshillave të vendotimit, përmes organeve të punës.

(10) Komisioni me akt të veçantë e përcakton formularin e listës së personave të autorizuar për mbikëqyrjen e punës së organeve dhe autoriteteve për zbatimin e zgjedhjeve.

(11) Shpenzimet për mbikëqyrjen e punës së organeve për zbatimin e zgjedhjeve i mbulojnë paraqitësit e listave të shpallura zgjedhore, përfaqësuesit e të cilëve mbikëqyrin punën e organit për zbatimin e zgjedhjeve.

Vëzhguesit vendas dhe të huaj

Neni 66

(1) Për regjistrimin e vëzhguesve vendas dhe të huaj të punës së organeve dhe autoriteteve për zbatimin e zgjedhjeve, zbatohen dispozitat e ligjit me të cilin rregullohet zgjedhja e deputetëve popullorë për vëzhgimin e punës së organeve për zbatimin e zgjedhjeve.

(2) Komisioni me akt të veçantë përcakton formularët për paraqitjen e aplikimeve për mbikëqyrjen e punës së organeve dhe autoriteteve për zbatimin e zgjedhjeve.

Pozita e përfaqësuesve të propozuesve të listave zgjedhore dhe të vëzhguesve

Neni 67

Në pozitën e përfaqësuesve të propozuesve të listave zgjedhore dhe të vëzhguesve zbatohen dispozitat e ligjit me të cilin rregullohet zgjedhja e deputetëve popullorë për vëzhgimin e punës së organeve për zbatimin e zgjedhjeve.

XIII MBROJTJA E SË DREJTËS ZGJEDHORE**Neni 68**

Dispozitat për mbrojtjen e së drejtës zgjedhore të ligjit që rregullon zgjedhjen e deputetëve popullorë zbatohen në mbrojtjen e të drejtës së votimit, por kërkesa për anulimin e votimit në vendvotim i paraqitet Komisionit.

XIV DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**Neni 69**

Formularët për zbatimin e veprimtarive zgjedhore caktohen nga Komisioni brenda pesë ditëve nga dita e marrjes së vendimit për shpalljen e zgjedhjeve.

Neni 70

Më ditën e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, ndërpritet vlefshmëria e Udhëzimit për zbatimin e zgjedhjeve të drejtpërdrejta për anëtarët e këshillave të pakicave kombëtare ("Fletorja Zyrtare e Republikës së Serbisë", nr 57/18 - tekst i pastruar).

Neni 71

(1) Ky udhëzim publikohet në "Fletoren Zyrtare të Republikës së Serbisë" dhe në ueb-faqen e Komisionit.

(2) Ky udhëzim hyn në fuqi më ditën e publikimit të tij në "Fletoren Zyrtare të Republikës së Serbisë".

02 Numër 013-1894/22

Në Beograd, më 5 shtator 2022

KOMISIONI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS

KRYETARI

Vladimir Dimitrijević